



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE

Tema e magjistraturës:

**APLIKIMI I TIK-ut NË MENAXHIMIN E SHKOLLAVE
(ANALIZË E SOFTUERËVE PËR ORARE)**

Kandidati:
Sinan Dermal

Mentori:
Prof. dr. Artan Luma

Tetovë, 2018

DEKLARATA E ORIGINALITETIT

Unë, Sinan Dermala, me anë të kësaj deklarate, dëshmoj me përgjegjësi të plotë se këtë punim e kam punuar vetë, pa përdorur ndonjë formë të ndihmës që nuk është e lejuar. Përmbajtja e punimit tim është mbështetur në referenca, nga literatura që kam shfrytëzuar dhe në njohuritë që i kam fituar gjatë studimeve.

Në rastet kur më është dashur të përdor citate, jam përpjekur që t'i përmbahem me përpikëri burimit, fjalë për fjalë, por ka raste kur informacionin e marrë nga burimi i caktuar e kam formuluar me pak fjalë, por gjithnjë duke vënë në fusnotë emrin e autorit dhe librit ku jam mbështetur. Të gjitha fjalitë dhe paragrafët që nuk kanë referenca të shënuara janë sintetizuar nga njohuritë e përgjithshme që kam në fushën e menaxhmentit. Vëmendje i kam kushtuar edhe kohezionit përmbajtjesor dhe lidhjes logjike të argumenteve të parashtruara në punim.

Deklaroj me përgjegjësi se këtë punim nuk e kam dorëzuar në asnjë institucion tjetër, për vlerësim apo qëllime të tjera.

FALËNDERIM

Dihet mirëfilli se gjatë procesit të punimit të temës, asgjë nuk do të ishte e mundur pa ndihmën e ofruar nga pedagogët, kolegët, institucionet etj. Së pari i jam mirënjohës mendores së temës, Prof. dr. Artan Luma, i cili gjeti kohë dhe ishte i gatshëm në çdo moment të më ndihmojë me këshillat e tij profesionale.

Një mirënjohje të veçantë e meriton edhe stafi i Gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, të cilët iu përgjigjën pozitivisht kërkesës sime për realizimin e anketave dhe intervistës.

Falënderoj edhe familjen time për përkrahje morale gjatë gjithë kohës.

REZYME

Është evidente fakti se vendet e zhvilluara i japin përparësi aplikimit të TIK-ut në procesin e menaxhimit të shkollës, e posaçërisht në hartimin e orareve mësimore. Kjo çështje, në Kosovë, nuk është aspak e trajtuar madje, mungon edhe në agjendat e udhëheqësve arsimorë për të marrë hapa konkret në këtë drejtim. Ky studim ka për qëllim të trajtojë procesin e aplikimit të TIK-ut në menaxhimin e shkollave (analizë e softuerëve për orare), duke marrë si rast studimi Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda - Toni" në Rahovec.

Ky studim ka një rëndësi të veçantë për disa arsye: *së pari* ai hedh dritë mbi praktikatat aktuale të cilat përdoren për krijimin e orareve mësimore. Deri më tani nuk ka kontribute në këtë drejtim. *Së dyti*, me qëllimin për të qenë sa më i thelluar dhe jo sipërfaqësor, studimi përfshin vetëm Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec. Përfshirja e shkollave të tjera në Komunën e Rahovecit do të kërkonte kontribut disavjeçar. *Së treti*, studimi përbën një përpjekje për hulumtimin e një dukurie për të cilën ka një ndjeshmëri të lartë shoqërore.

Hipoteza e përgjithshme e këtij studimi është: Shkolla e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, posedon mundësitë e TIK-ut për një menaxhim të suksesshëm të shkollës, përkatësisht të përpilimit të orareve mësimore .

Përzgjedhja e metodave për realizimin e këtij studimi është bazuar dhe përshtatur sipas natyrës së hulumtimit. Është përdorur metoda empirike, me ç'rast kemi përdorur të dhëna sasiore (anketa) dhe cilësore (intervista) si dhe metoda krahasuese ku kemi bërë krahasime me Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec. Hulumtimi do të shërbejë si pikënisje për Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda - Toni" në Rahovec, por edhe për shkollat tjera në Kosovë, për të ndërmarrë hapa konkretë drejt aplikimit të TIK-ut në menaxhimin e shkollës, përkatësisht në krijimin e orareve mësimore.

Fjalët kyçe: TIK; Shkolla; Orari shkollor, Orari.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT.....	2
FALËNDERIM.....	3
REZYME.....	4
PËRMBAJTJA.....	5
KAPITULLI I.....	7
1. HYRJE.....	7
1.1. Përcaktimi i problemit.....	7
1.2. Qëllimi.....	8
1.3. Objektivat.....	8
1.4. Pyetjet kërkimore.....	9
1.5. Hipotezat.....	9
1.6. Struktura e punimit.....	10
1.7. Rëndësia e punimit.....	10
KAPITULLI II.....	12
2. RISHIKIMI I LITERATURËS.....	12
2.1. Kuptimi i orarit mësimor.....	12
2.2. Kërkesat për orar të përshtatshëm mësimor.....	14
2.3. Problemet me oraret shkollore.....	15
2.4. Aplikacionet dhe softuerët e aplikueshëm për krijimin e orareve mësimore.....	16
2.4.1. Përdorimi i aplikacionit MS Excel për oraret mësimore.....	17
2.4.2. Softuerët e krijuar enkas për krijimin e orareve mësimore.....	18
KAPITULLI III.....	22
3. METODOLOGJIA E PUNËS.....	22
3.1. Metoda.....	22
3.2. Natyra e studimit.....	22
3.3. Interesi aktual për temën.....	22
3.4. Strategjia e kërkimit.....	23
3.5. Popullata dhe kampioni i zgjedhur.....	24
3.6. Instrumentet e kërkimit.....	24

3.7. Analiza e të dhënave.....	24
KAPITULLI IV.....	26
4. DIZAJNIMI I PYETËSORIT DHE UDHËZUESIT TË INTERVISTAVE.....	26
4.1. Ndërtimi i pyetësit.....	26
4.2. Ndërtimi i udhëzuesit të intervistës.....	26
4.3. Validiteti i pyetësorëve dhe udhëzuesit të intervistave.....	27
KAPITULLI V.....	28
5. ANALIZË E GJETJEVE EMPIRIKE	28
5.1. Analizë e të dhënave sasiore.....	28
5.2. Analizë e të dhënave cilësore.....	47
5.3. Analiza e korrelacionit.....	47
KAPITULLI VI.....	40
6. DISKUTIME.....	49
6.1. Diskutime lidhur me analizat e të dhënave sasiore.....	49
6.2. Diskutime lidhur me analizat e të dhënave cilësore.....	50
6.3. Krahasim i rezultateve të punimit me rezultatet e hulumtimit me shkollë tjetër	51
6.4. Analizë krahasuese.....	52
6. 5. Verifikimi i hipotezave.....	53
6.6. Vlefshmëria e studimit.....	54
PËRFUNDIMI.....	55
REKOMANDIMET.....	57
BIBLIOGRAFIA.....	59
WEBLIOGRAFIA.....	61
SHTOJCA 1: PYETËSOR.....	62
SHTOJCA 2: UDHËZUES INTERVISTE.....	64
SHTOJCA 3: DEKLARATA E LEKTORIT.....	65
SHTOJCA 4. LEJA NGA DKA – RAHOVEC.....	66

KAPITULLI I

1. HYRJE

Përdorimi i teknologjisë nga udhëheqësit e shkollave të Kosovës ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme këto vitet e fundit. Qeveria dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, janë përpjekur ta përmirësojnë dhe ta krijojnë një infrastrukturë të shëndoshë teknologjike në shkollat fillore dhe të mesme. Këto përpjekje kanë qenë në materiale dhe ndërtim kapacitetesh njerëzore.

Nga kjo tentativë janë kërkuar edhe rezultate; rezultati ose përfitimi nga këto ndryshime është përdorimi i investimeve maksimale i këtyre burimeve të krijuara për maksimizimin e procesit të të mësuarit. Plani strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016 thekson se arsimi në Republikën e Kosovës do të pajisë shkollat në AMU, respektivisht në Arsimin e Mesëm të Lartë (AML) me njohuritë e nevojshme, me aftësitë e shkathtësitë e mjaftueshme, të edukuar dhe të përkushtuar për të realizuar planin kombëtar ekonomik e zhvillimor të vendit.

1.1. Përcaktimi i problemit

Orari mësimor ndryshon nga shkolla në shkollë, nga qyteti në qytet, e posaçërisht nga vendi në vend. Kjo ndodh për shkak të karakteristikave dhe rregulloreve specifike të sistemeve arsimore. Numri dhe zgjatja e ligjëratave në klasë po ashtu dallon nga klasa në klasë për shkak të niveleve të ndryshme të shkollës.

Edhe pse në literaturat e huaja ka mjaft studime sa i përket orareve mësimore të shkollave, kjo çështje nuk është aspak e trajtuar në vendin tonë. Madje, nuk janë të trajtuara as temat që prekin këtë çështje. Për më tepër, në Kosovë mungojnë edhe studimet krahasuese për suksesin e metodologjive të ndryshme që aplikojnë shkollat për përgatitjen e programit mësimor. Ky studim ka për qëllim të trajtojë procesin e aplikimit të TIK-ut në menaxhimin e shkollave (analizë e softuerëve për orare), duke marrë si rast studimi Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda - Toni" në Rahovec.

Edhe pse përgatitja e orarit mësimor nëpër shkolla është mjaft komplekse, kjo çështje nuk është organizuar e as nuk organizohet nga një sistem i përbashkët apo unik arsimor,

por secila shkollë e përgatitë orarin përkatës në formë të izoluar apo pa u konsultuar me të tjerët.

Konkretisht, do të trajtojmë problemet me të cilat ballafaqohet kjo shkollë lidhur me përgatitjen e orarit mësimor. Orari mësimor përfshin orarin për nxënësit, orarin për provimet, oraret për shkollën. Oraret për shkollën janë kryesisht të menaxhuara nga Ministria e Arsimit, e cila qysh në fillim të vitit shkollor lëshon rregulloren e cila përcakton se cilat janë ditë pune dhe cilat janë ditë pushimi apo ditë feste.

Jam përcaktuar për të hulumtuar këtë temë me qëllim që të kemi një pasqyrë të qartë se sa përdoret Teknologjia Informative në menaxhimin e shkollës, konkretisht përdorimi i TIK-ut në përgatitjen e orareve mësimore të shkollës.

Konsideroj se ky studim do të shërbejë si një pikë referuese për Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda - Toni" në Rahovec, por edhe për shkollat tjera në Kosovë, përmes së cilit do t'i ofrojmë mundësitë më të mira softuerike për të përgatitur oraret mësimore, që ato mos të bëhen në mënyrë tradicionale si deri më tash.

1.2. Qëllimi

Ky studim ka si qëllim të trajtojë procesin aplikimit të TIK-ut në menaxhimin e orareve mësimore në Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, si dhe të bëjë një analizë të softuerëve për oraret mësimore të cilat përdoren në vendet e zhvilluara.

1.3. Objektivat

Objektivat e këtij studimi janë:

1. Të shqyrtohet literatura bashkëkohore dhe ajo e mëparshme (vendore dhe ndërkombëtare) në lidhje me oraret mësimore në shkollat fillore dhe të mesme.
2. Të analizohen metodat aktuale me të cilat Shkolla e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, i përgatitë oraret mësimore.
3. Të identifikohen problemet të cilat pengojnë në aplikimin e mundshëm të softuerëve të ndryshëm për krijimin e orareve.
4. Të përcaktojnë përparësitë që posedon Shkolla e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, për të aplikuar TIK-un në menaxhimin e shkollës, përkatësisht, në përpilimin e orareve bazuar në këtë teknologji.

5. Të evidentohen mekanizmat për zbutjen e problemit të aplikimit të TIK-ut në menaxhimin e orareve mësimore në Shkollën e Mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec.

1.4. Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore, që udhëhoqën realizimin e këtij studimi lidhur me aplikimin e TIK-ut në menaxhimin e Shkollës së Mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec janë:

1. Cilat metoda i përdorë Shkolla e Mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec për krijimin e orareve mësimore?
2. Cilat janë problemet të cilat pengojnë aplikimin e softuerëve për krijimin e orareve mësimore?
3. Cilat janë përparësisë të cilat i posedon Shkolla e Mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, të cilat do të mund të ndihmojnë aplikimin e TIK-ut në menaxhimin e shkollës (përpilimin e orareve mësimore)?

1.5. Hipotezat

Hipoteza e përgjithshme:

H0. Shkolla e Mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, posedon mundësitë e TIK-ut për një menaxhim të suksesshëm të orareve mësimore.

Hipotezat e veçanta:

H1. Shkolla e Mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, ka staf të kualifikuar të cilët kanë njohuri të mjaftueshme të Teknologjisë Informative, të cilët po që se stimulohen do të ndikonin në menaxhimin e suksesshëm të orareve mësimore përmes TIK-ut.

H2. Shkolla e Mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec posedon pajisje të mjaftueshme të Teknologjisë Informative, të nevojshme për një menaxhim të suksesshëm të orareve mësimore.

H3. Në Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec mungon stimulimi për stafin me përgatitje të mjaftueshme të TIK-ut, të cilët do të jepnin kontributin e tyre në menaxhimin e orareve mësimore.

1.6. Struktura e punimit

Ky punim masteri përmban gjashtë kapituj:

Në kapitullin e parë, përvijohet përcaktimi i problemit, qëllimi, objektivat, pyetjet kërkimore, hipotezat si dhe struktura e punimit.

Rishikimin e literaturës e kemi strukturuar në kapitullin e dytë në të cilën flasim për kuptimin e orarit shkollor, kërkesat për orar të përshtatshëm shkollor, si dhe softuerët e aplikueshëm për krijimin e orareve mësimore.

Kapitulli i tretë përmban metodologjinë e punës, ku janë të paraqitura natyra e studimit, interesi aktual për temën, metodat, strategjia e kërkimit, popullata dhe kampioni i zgjedhur si dhe instrumentet e kërkimit.

Kapitulli i katërt përshkruan dizajnimin e pyetësorit dhe udhëzuesit të intervistave, ku i kemi paraqitur në detaje mënyrat e ndërtimit të këtyre instrumenteve.

Analiza e gjetjeve empirike radhitet në kapitullin e pestë, ku i kemi paraqitur analizën e të dhënave sasiore si dhe analizën e të dhënave cilësore. Këtu kemi dhënë edhe analizën korrelacionare të variablave të paraqitura në këtë temë.

Në kapitullin e fundit, të gjashtë, kemi diskutuar analizat e të dhënave sasiore, analizat e të dhënave cilësore, krahasimin e rezultateve me Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec si dhe analizën krahasuese. Këtu kemi paraqitur edhe verifikimin e hipotezave si dhe vlefshmërinë e studimit. Punimi përmbillet me përfundimin dhe rekomandimet.

1.7. Rëndësia e punimit

Kjo temë ka një rëndësi të veçantë për disa arsye:

- *së pari* ai hedh dritë mbi praktikat aktuale të cilat përdoren për krijimin e orareve mësimore . Deri më tani nuk ka kontribute në këtë drejtim.

- *së dyti*, me qëllimin për të qenë sa më i thelluar dhe jo sipërfaqësor, studimi përfshin vetëm Shkollën e Mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec. Përfshirja e shkollave të tjera në Komunën e Rahovecit do të kërkonte kontribut disavjeçar.
- *së treti*, studimi përbën një përpjekje për hulumtimin e një dukurie për të cilën ka një ndjeshmëri të lartë shoqërore.

KAPITULLI II

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1. Kuptimi i orarit mësimor

Me orar nënkuptojmë orët e caktuara kur nis ose kryhet diçka apo brenda të cilave zhvillon veprimtarinë një institucion (në rastin tonë institucionet shkollore). Pra, orari është një pasqyrë ku shënohen orët kur bëhet diçka, vendi ku bëhet, radha e veprimeve si dhe personat (mësimdhënësit) përgjegjës për atë veprimtari (Kostallari, 1981).

Sipas Wren, orari është shpërndarja, në varësi të kufizimeve, e burimeve të dhëna për objektet që vendosen në kohë - hapësirë, në mënyrë të tillë që të arrijë në mënyrë sa më të kënaqshme objektivat e dëshiruara (Wren, 1996).

Problemi i përgjithshëm i orareve vjen në shumë forma të paraqitjes, përfshirë orarin e infermierëve, orarin e sporteve, orarin e transportit publik, orarin shkollor, e të tjera (Burke, 2007).

Orari shkollor është caktimi i vazhdueshëm i kohës, klasave (kabineteve), mësimdhënësve, nxënësve, për të organizuar aktivitetet në mënyrën më të kënaqshme sipas preferencave të nxënësve, mësimdhënësve si dhe vet shkollës.

Komponentët që përfshihen në orarin shkollor janë:

- Aktivitetet (orët mësimore, orët praktike apo aktivitetet tjera në klasë);
- Koha (ditët, javët apo muajt brenda një gjysmë-vjetori);
- Burimet (mësimdhënësit, dhomat e mësimi (kabinetet) laboratorët);
- Klasa (grupi i nxënësve që marrin pjesë në aktivitete të njëjta).

Oraret mësimore zakonisht u përmbahen dy kufizimeve që janë të patjetërsueshme. Ato janë: kufizimet e detyruara dhe kufizimet e dëshiruara. Këto dallojnë shumë nga njëra-tjetra. Kufizimet e detyruara janë kufizime të cilat duhet të përmbushen domosdo në orar me qëllim që të jetë orari i realizueshëm (Pillay, (n.d)).

Kufizimet e detyruara duhet të përmbushen në çdo rrethanë. Për shembull, asnjë nxënës nuk mundet të ketë dy lëndë mësimore ore dy provime në të njëjtën kohë (Masri Ayob; Abdul Razak Hamdan; Salwani Abdullah; Zalinda Othman; Mohd Zakree, et al., 2011). Kufizimet e dëshiruara¹ përcaktojnë cilësinë e orarit. Këto janë zakonisht kontradiktore, dhe si të tilla është e pamundur për t'i përmbushur të gjitha kufizimet e dëshiruara.

Përgatitja e orareve mësimore me një numër të madh orësh mësimore, për një numër të madh nxënësish, një numër klasash, është proces mjaft kompleks, i cili shpesh herë është zgjidhur në mënyrë manuale nga stafi menaxhues i shkollës, edhe pse rezultatet nuk kanë qenë çdo herë të kënaqshme (Limbran Sampebatu; Aries Kamolan, 2016).

Në kalendarin e shkollës, kërkohet të planifikohen një sërë takimesh mes nxënësve dhe mësimeve. Oraret që rezultojnë duhet të jenë të realizueshme dhe të pranueshme për të gjithë njerëzit e përfshirë. Megjithatë, shkollat ndryshojnë në politikat e tyre arsimore, problemi i orarit shkollor ndodh në disa variacione. Megjithatë, një grup entitetesh dhe kufizimet e detyruara mes tyre janë të zakonshme në këto ndryshime (Marte, 2012).

Orari mësimor përfaqëson aktivitetin më të rëndësishëm të planifikimit në kalendarin e shkollës [Learning and Teaching Scotland, 2006]. Kjo gjë përcakton, mirëmban dhe rregullon aktivitetin e mësimeve dhe mësimit të shkollës dhe siguron ofrimin e arsimit cilësor për të gjithë nxënësit [Asratian and de Werra, 2002].

Në shumicën e situatave praktike, numri i përgjithshëm i orareve mësimore të caktuara për çdo klasë është shumë më i madh se numri i përgjithshëm i orareve mësimore të caktuara për secilin mësues; prandaj, është pothuajse e sigurt se ka mjaft zgjidhje të mundshme që plotësojnë kërkesat e kompaktësisë së nxënësit. Në të kundërtën, zakonisht nuk kërkohet kompaktësia për mësuesin, por në disa raste kjo preferohet fuqimisht dhe njihet si tipar i cilësisë [Valoux dhe Housos, 2003].

Një burim shtesë i kompleksitetit në problemet e përcaktimit të orarit mësimor rezultojnë nga kërkesat për oraret mësimore të njëpasnjëshme [Eikelder dhe Willemen, 2001]. Kjo

¹ Te kufizimet e dëshiruara përfshihen aktivitetet jashtë skollore, ose aktivitete jo –të përditshme që ndodhin papritur dhe nuk janë të përfshira në orarin shkollor.

ndodh, sidomos, në orarin e shkollave të mëdha, ku një përqindje e madhe e orëve mësimore kërkojnë blloqe të leksioneve me dy, tre ose më shumë periudha kohore të njëpasnjëshme. Prandaj, është mjaft e dobishme për ta çliruar këtë pengesë [Daskalaki dhe Birbas , 2005].

2.2. Kërkesat për orar të përshtatshëm mësimor

Problem i krijimit të një orari shkollor të përshtatshëm përfshin orarin për orë mësimore, orarin për mësimdhënës, orarin për klasa të ndara në numër fiks, me qëllim që këto të paraqiten në një numër fiks tabelor, në atë mënyrë që asnjë mësimdhënës, asnjë dhomë mësimi të mos përsëritet dy herë brenda një periudhe kohore (D. Abramson J. Abela, 1992).

Që një orar të jetë i përshtatshëm në praktikë, kërkesat dallojnë nga kategoria në kategori. Këto kërkesa mund të definojnë si më poshtë:

- Statistikat e përgjithshme – Numri i orëve mësimore, numri i mësimdhënësve, numri i ditëve apo i javëve.
- Afatet kohore të mundshme – Numri dhe kohëzgjatja e periudhave të mundshme. (këtu mund të përmendim gjysmë-vjetorin pranveror dhe vjeshtor, ose orarin e paradites dhe të pasdites për secilën ditë apo sezon.
- Kërkesat e orëve mësimore – këto kërkesa specifikohen në numrin e kohëve që mësimdhënësi duhet të jetë në orë mësimore në tërë gjysmë-vjetorin.
- Kërkesat e klasave (kabineteve) – këtu bëhet përcaktimi se cilat paralele do të vendosen në cilat dhoma mësimore (kabinete). Në këto raste duhet të ketë parasysh numri i nxënësve apo madhësia e paraleles, për shkak se hapësira duhet t'i përmbushë kapacitetet për një numër të caktuar të nxënësve. Ka raste kur lëndët specifike kërkojnë klasa specifike si p.sh. lënda e TIK-ut duhet të mbahet në kabinete të pajisura me kompjuterë, ose orët e edukatës fizike në sallat e sportit etj.
- Kërkesat e mësimdhënësve - Çdo orë apo ngarkesë e mësimdhënësve duhet të jetë konform kërkesave që janë të përcaktuara me rregulloret e Ministrisë së Arsimit. Pra, secili mësimdhënës ka orët e caktuara për një javë, këto duhet të specifikohen.

- Pamundësia e mësimeve - Mësimdhënësit janë zakonisht të zënë për periudha të caktuara. Ndoshta ata janë të ngarkuar edhe në procese të tjera administrative. Por, ka mundësi kur mësimeve duhet t'i ndahen edhe ditë të lira gjatë javës. Ka shkolla të cilat angazhojnë mësimeve me orar gjysmë të plotë, ose i angazhojnë ata në dy, tri shkolla të ndryshme, (në paralele të ndara) për të plotësuar normën që e kërkon rregullorja e MASHT-it.
- Preferencat e mësimeve – në procesin e përgatitjes së orarit mësimor, ka mësimeve që kanë preferencat e tyre për të dhënë mësim në periudha të caktuara dhe kërkojnë të jenë të lirë në periudha të tjera.

Mund të duket e parëndësishme, por në hartimin e orareve mësimore, janë të rëndësishme edhe pauzat apo kohët e pushimit, të cilat ndahen në pushime të gjata dhe ato të shkurta. Të gjatat kryesisht shërbejnë për kohë dreke apo mëngjesi.

2.3. Problemet me oraret shkollore

Problemi i orarit mësimor të një shkolle ka të bëjë me caktimin javor të të gjitha orëve mësimore të një shkolle. Problemi qëndron në caktimin e orëve mësimore në periudha në mënyrë të tillë që asnjë mësimeve (ose klasë) të mos përfshihet në më shumë se një orë mësimore në një kohë të njëjtë [Schaerf, 1999].

Zgjidhja manuale e problemit të orarit mësimor zakonisht kërkon disa ditë pune. Përveç kësaj, zgjidhja e fituar mund të jetë e pakënaqshme në një farë mënyre; për shembull, një mësimeve mund të jetë i paangazhuar për një orë midis orëve mësimore që ka nëpër klasa.

Për arsyt e mësipërme, vëmendje e konsiderueshme i është kushtuar orarit mësimor të automatizuar. Gjatë dyzet viteve të fundit, duke filluar në fillim të viteve 60 me Gotlieb [Gotlieb, 1964] dhe të tjerë, në konferenca [Paechter, 1995] dhe [Burke, 1997], dhe në revista janë shfaqur shumë dokumente lidhur me orarin mësimor të automatizuar, dhe janë zhvilluar dhe aplikuar disa aplikacione me sukses të arsyeshëm.

Kohët e fundit, në literaturë u shfaqën disa qasje të bazuara në teknika të reja kërkimi; ndër të tjera janë simuluar algoritmet gjenetike [12], kënaqësitë e kufizimit [Yoshikawa, 1996] dhe kombinimi i metodave të ndryshme [Cooper, 1993]. Problemi ka një numër të

madh variantesh, në varësi të vendit, llojit të shkollës, dhe madje edhe në specifikat e shkollës [Schaerf, 1995].

Secili problem i orarit shkollor përcaktohet në terma të një numri të grupeve të nxënësve, të mësimdhënësve, dhe klasave në dispozicion. Zgjidhja e problemit të orarit mësimor në thelb përfshin ndarjen e grupit të nxënësve, mësimdhënësve dhe klasave brenda hapësirave të orarit, në mënyrë që të plotësojnë kufizimet e detyruara dhe të dëshiruara të problemit [Beligiannis et al. 2008].

Post et al. [2008] përshkruan grupet e nxënësve, mësimdhënësit dhe klasat si burime që do të ndahen. Nxënësit zakonisht grupohen në klasa para procesit të ndërtimit të orarit [Abramson 1991].

Problemi i orarit mësimor të shkollës ndryshon për secilin vend për shkak të karakteristikave dhe rregulloreve specifike për sistemin e veçantë shkollor [Post et al. 2008].

Në disa raste grupet e nxënësve nuk është pjesë më e rëndësishme e organizimit se sa grupet mësimdhënësve të cilëve duhet t'iu ndahen periudhat kohore dhe klasat [Wilke dhe Ostler 2008]. Në këto raste duhet të sigurohen madhësitë e klasave.

Po ashtu, duhet të përcaktohet një listë e grupeve të nxënësve dhe kapacitetet e tyre korresponduese. Në disa shkolla disa objekte, të tilla si terrenet sportive, ndahen me shkolla të tjera [Alvarez Valdes et al. 2002]. Në këto raste, shkolla parashikon një mësimdhënës të kualifikuar për të mbajtur orë në klasa të niveleve të ndryshme [De Haan 2004].

2.4. Aplikacionet dhe softuerët e aplikueshëm për krijimin e orareve mësimore

Ka shumë njerëz që kanë përvojë në krijimin e tabelave për përgatitjen e orarit mësimor, por ka edhe shumë të tillë të cilët nuk kanë qëndrime pozitive për krijimin e tabelave. Hulumtimet në këtë fushë, edhe pse janë të ndërlikuara, ende nuk janë afër zgjidhjes së një problemi për krijimin e orareve. Për më tepër, reformat e vazhdueshme në arsim, kanë ndikuar që edhe shumë hulumtues të merren me këtë çështje. Disa nga konceptet

e tyre mund të përdoren në jetën e përditshme për të zgjidhur problemet me krijimin e orareve mësimore.

2.4.1. Përdorimi i aplikacionit MS Excel² për oraret mësimore

Është për tu habitur fakti pse ende nuk ekziston një format standard për shkëmbimin e të dhënave në fushën e krijimit të orareve mësimore. Një format i pranueshëm do të lehtësonte procedurat në këtë fushë. Pjesa dërmuese e shkollave për të mbuluar këto zbrazëtira e përdorë formatin XML (Excel) për të krijuar oraret mësimore.

XML është zgjedhur të përdoret gjerësisht në ditët e sotme në shumë shërbime si mjet për shkëmbimin e të dhënave në mes të aplikacioneve (Gerhard Post; Samad Ahmadi; Sophia Daskalaki; Jeffrey H. Kingston; Jari Kyngas; Cimmo Nurmi; Ranson, 2010). Ana pozitive e Excel konsiston në faktin se të dhënat janë të strukturuar, dhe si rezultat në këtë program mund lehtë të bëhen ndryshime.

Në Excel ruhen dhe përpunohen mjaft mirë e bukur tabelat. Në këto tabela, përveç ruajtjes së të dhënave, mund të bëhen edhe kalkulime (llogaritje) të vlerave, të formulave dhe funksioneve të ndryshme (Kasumi, 2005).

Gjuhët e programimit kanë biblioteka softuerësh që e bëjnë të lehtë për të trajtuar XML. Nëse flasim me gjuhën e matematikës, XML është një pemë e rrënjësuar, me informacione të bashkangjitura në nyje. Sipërfaqja punuese e Excel-it është një tabelë e madhe. Ajo është e organizuar nëpër fleta (sheet), numri i të cilave zakonisht është tri, por që mund të ndryshohet sipas dëshirës dhe nevojës.

Tabela krijohet si prerje e kolonave (shtyllave, *columns*) dhe rreshtave (rendeve, *rows*). Të dhënat në Excel mund të jenë: tekst, numra, datë, kohë, valutë, etj. Kjo mundësi është edhe shkaku që pjesa dërmuese e institucioneve shkollore i krijojnë oraret mësimore përmes aplikacionit Excel.

² MS Excel bën pjesë në pakon Microsoft Office

2.4.2. Softuerët e krijuar enkas për krijimin e orareve mësimore

Teknologjia informative ka sjellë mjaft lehtësira në menaxhimin e shkollës, përkatësisht në përpilimin e orareve mësimore përmes softuerëve të ndryshëm. Janë të njohura: aSc Timetables, TimeTabler, FET Time table, Prime timetable, Proclass, Wise Timetable, Mimosa, Untis Express, SchoolEdge Timetable, me ç'rast do të paraqesim karakteristikat e secilës veç e veç.

a) Softueri aSc Timetables

Ky softuer është i krijuar për përgatitjen e programeve mësimore. Ka gjetur një përdorim të gjerë në shkolla të ndryshme fillore dhe të mesme. Gjenerimi i këtij programi bëhet në mënyrë automatike, pa ndërhyrje të faktorit njeri. Edhe nëse oraret janë caktuar me program paraprakisht, ky softuer krijon mundësinë që për ndonjë ndryshim eventual të bëhet me dorë apo në mënyrë manuale. Algoritmi i tij shumë shpejt i evidenton konfliktet brenda orarit mësimor. Është mjaft e lehtë për tu përdorur, me një sistem të lehtë të futjes së të dhënave në të. Ajo është e qasshme edhe në pajisjet tjera të mësimdhënësve dhe nxënësve, siç janë mobilët.

E veçanta e këtij program është se ky i përkrah edhe oraret mësimore në disa ndërtesa si dhe bën të mundur lëvizjet ndërmjet ndërtesave shkollore. Për shkak se aSc Timetables përdoret thuajse në shumë vende të botës, program është dizajnuar që t'i plotësojë kërkesat regjionale të mbarë botës (<http://www.asctimetables.com>). Ky program funksionon që 20 vjet, përdoret në 173 shtete dhe në 150.000 shkolla.

b) Softueri TimeTabler

TimeTabler është program kompjuterik i shpejtë dhe i favorshëm. Me një eksperiencë shumëvjeçare, është i dizajnuar për të ndihmuar institucionet që të krijojnë oraret e tyre shpejt dhe saktë. Ky program nuk kërkon njohuri kompjuterike dhe përdoret në mënyrë shumë të lehtë. TimeTabler vazhdimisht u zhvillua dhe u përmirësua nga ekipi i ekspertëve të saj me një përvojë prej 40 vjetësh, duke ofruar shërbime për një numër të madh përdoruesish për situata të ndryshme (<http://www.timetabler.com>). Përdoret në

më shumë se 80 vende të botës. Ky program mundëson që të zgjidhë probleme të shumta e komplekse të përgatitjes së orareve mësimore.

c) Softueri FET Time table

Ky program është falas, i licencuar nga GNU Affero General Public License. Programi ofron mundësi të gjenerimit të algoritmeve në mënyrë automatike apo gjysmë-automatike ose manuale. Ky program mund të implementohet në platforma të pavarura, mundësohet në GNU/Linux, Windows, Mac dhe ndonjë sistem tjetër (<http://lalescu.ro/liviu/fet/>). Programi është fleksibil në strukturën e nxënësve, në vitet shkollore, ndërrimet e paradites dhe pasdites e të tjera. Programi ofron numrin maksimal të ditëve të punës për javë (35), numrin maksimal të orëve për një ditë (60), numrin maksimal të mësimdhënësve (6000), numrin maksimal të studentëve (30000), numër të pakufizuar lëndësh dhe aktiviteteve, numrin maksimal të klasave – dhomave mësimore (6000) numër maksimal të ndërtesave (6000).

d) Softueri Prime Timetable

Prime Timetable është program për krijimin e orareve të shkollës, e dizajnuar për orare manual dhe automatike. Kjo mund të përdoret në pajisje të ndryshme, si: Mac, PC, tablet, smartfone (<http://www.primetimetable.com/#intro&id=09c6044a-1a05-4f99-b9a6-fa7f3cc8a0f9>), etj. Prime Timetable përdoret për krijimin e orareve mësimore për shkollat fillore, shkollat e mesme, kolegjet, universitetet, shkollat ndërkombëtare, si dhe për organizata të tjera arsimore. Ky program përdoret edhe për të krijuar orare për aktivitete të ndryshme si kurse të ndryshme kampe shkollore etj.

e) Softueri Proclass

Softueri Proclass (<http://www.proclassonline.com>) ka për qëllim kryesor menaxhimin e klasës. Është i sigurt dhe ka përdorim të lehtë. Karakteristikat e këtij softueri përfshijnë orare fleksibile, kapacitete të menaxhimit, përcaktime të lokacioneve dhe klasave, dhe shumë gjëra të tjera.

f) Softueri Wise Timetable

Ky program ka gjetur përdorim qysh para 15 vjetëve, si projekt i madh hulumtues për universitete të mëdha të Evropës Qendrore. Konsiderohej si një ndërmarrje e madhe e

cila mbulonte problemet komplekse të orareve mësimore. Ky sistem u ridizajnuar disa herë me teknologjitë më të reja të mundshme., duke ofruar te përdoruesit e saj ambient modern dhe shumë të përafërt.

Kjo ishte edhe mënyra që kompania prodhuese të plasojë një softuer të mundshëm në treg, nga shumë universitet dhe kolegje. Softueri është krijuar përgatitur nga njerëz me shumë eksperiencë në këtë fushë, të cilët arritën t'i plotësojnë kërkesat e shumta në shkolla dhe universitete (<http://www.wisetimetable.com/about.htm>).

Kompania prodhuese e këtij softueri, u ofron institucioneve dhe organizatave gjëra të reja në këtë program, nëse ata kanë kërkesa shumë të veçanta apo specifike. Kjo është edhe mënyrë se si ata praktikisht i mbulojnë kërkesat që i marrin nga klientët.

g) Softueri Mimosa

Ky program është mjaft i larmishëm. Programi është i dedikuar për klasa dhe mësues, për orët mësimore, për oraret e studentëve, për provimet, për kolokuiumet apo seminarët etj. Programi Mimosa, nënvizon të gjitha ditët e përzgjedhura të kalendarit. Ky program në mënyrë automatike i detekton konfliktet që dalin në oraret mësimore. Programi është i dizajnuar, për lëndët mësimore, për mësimdhënësit, për klasat apo dhomat e mësimit, për nxënësit e ndarë në paralele dhe vite etj. Programi po ashtu mundëson organizmin e orareve për aktivitete të ndryshme shkollore, për festa të ndryshme e të tjera. E veçanta e këtij programi është se i përkrah kalendarët përëndimor, islamikë, si dhe hebre (<http://www.mimosasoftware.com/>).

h) Softueri Untis Express

Units Express është program mjaft i lehtë për t'u përdorur. Sistemi i futjes së të dhënave ndihmon përdoruesit të fusin të dhënat bazë të shkollës. Programi përcakton saktësisht, cili mësimdhënëës është në dispozicion në cilën kohë. Programi po ashtu mund të shmangë orët e matematikës në orët e fundit (<http://www.school-timetable.com/>). Orari kombinon numrin e mësimdhënësve, klasave, lëndëve, dhe dhomave mësimore.

Algoritmi i Units Express nuk e kalkulon vetëm një rezultat por shumë rezultate të ndryshme. Pastaj, përdoruesi e zgjedh cilën dëshiron. Programi po ashtu përcakton se cilat kritere janë më të rëndësishme e cilat mund të evitohen nëse është e nevojshme.

i) Softueri SchoolEdge Timetable

Programi SchoolEdge Timetable është program i integruar administrativ për institucionet parashkollore, për shkollat fillore, të mesme si dhe për kolegjet. Përveç menaxhimit të orareve mësimore, modulet e këtij programi mbulojnë edhe kërkesa të tjera administrative si: të dhëna për studentët, menaxhimin e ekskursioneve, menaxhimin e financave të shkollës e të tjera. Programi ofron zgjidhje të shpejtë për qasje në oraret mësimore, dhomat mësimore në dispozicion si dhe ndryshime të orarit mësimor nëse është e nevojshme (<https://www.humanedge.biz/education.html>).

Programi ofron edhe mundësi të paparashikuara, për shembull në rast se mungon një mësimdhënës, në rast se bëhet ndërrimi i dhomave mësimore. Programi ofron edhe mundësinë që të shpërndajë ndonjë risi me stafin në rast se ndodh ndonjë ndryshim.

KAPITULLI III

3 METODOLOGJIA E PUNËS

3.1. Metoda

Përzgjedhja e metodave për realizimin e këtij studimi u bazua dhe u përshtat sipas natyrës së hulumtimit. U përdorë metoda empirike, me ç'rast punuam me të dhëna sasiore (anketa) dhe cilësore (intervista) si dhe metoda krahasuese, ku realizuam hulumtime edhe në Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec, pastaj bëmë krahasime lidhur me problemin e përdorimit të softuerëve për programet mësimore.

3.2. Natyra e studimit

Ky studim ka një natyrë hulumtuese në disa linja:

Së pari, natyra e studimit është analitike - diakronike, pra hulumtohen programet ndryshme softuerike të cilat sot gjejnë përdorim të gjerë në institucionet arsimore me qëllim të lehtësimit të përgatitjes së orareve mësimore.

Së dyti, studimi ka natyrë eksploruese/shpjeguese, duke u mbështetur në burime dytësore si: literatura e mëparshme mbi procesin e orareve mësimore, ku do të trajtohet rëndësia e tyre, kompleksiteti i tyre, kërkesat që kërkohen për një orar të përshtatshëm e të tjera.

Së treti, studimi ka natyrë hulumtuese empirike, duke u mbështetur në metoda sasiore, si anketimi, dhe cilësore si intervistimi. E veçanta e këtij studimi është se, anketimi u realizua duke pyetur të gjithë mësimdhënësit e Shkollës së Mesme "Xhelal Hajda – Toni" – në Rahovec, si dhe u realizuan intervista me të gjithë mësimdhënësit e TIK-ut.

3.3. Interesi aktual për temën

Pas luftës së vitit 1999, në Kosovë ndodhën ndryshime të mëdha në të gjitha porët e jetës. Zhvillim të hovshëm pat edhe procesi arsimor, me ç'rast u përmirësuan infrastrukturat shkollore, u zhvilluan reforma të reja në arsim e shumë ndryshime të tjera. Një ndryshim i madh ndodhi edhe në fushën e teknologjisë Informative.

Me gjithë faktin se teknologjia informative ka një zhvillim të hovshëm në Kosovë, në shkollat tona aplikimi i saj nuk është në nivel të duhur për shkaqe të ndryshme. Prandaj i vura vetës qëllim që të bëj një studim të gjerë me këtë problematikë, me qëllim që të vë në pah mundësitë që kanë shkollat për të lehtësuar dukshëm punët e tyre, sidomos në përpilimin e orareve mësimore të cilat në shumë raste punohen në mënyrë manuale, ose në raste të rralla me programin Excel.

Evidentimi i mundësive që kanë shkollat për ta aplikuar teknologjinë informative në menaxhimin e shkollave do të ndikojë dukshëm në marrjen e hapave për të ecur përpara në këtë drejtim.

3.4. Strategjia e kërkimit

Për realizimin e këtij studimi kemi ndjekur një strategji kërkimore e përpiktë, në mënyrë që planifikimi dhe kryerja e tij të ishin sa më profesionale.

Hapi i parë i këtij studimi kishte të bënte me hulumtimin e të dhënave dytësore dhe krijimin e një ideje të qartë për çështjen (problemin) studimore. Çështja e aplikimit të TIK-ut në menaxhimin e shkollave (softuerët për oraret mësimore), përbën një fushë ende të pa eksploruar siç duhet, prandaj lipset t'i kushtohet një vëmendje e veçantë hulumtuese në një nivel shkencor.

Hapi i dytë, pas përcaktimit të temës për studim, hartuam qëllimin objektivat, pyetjet kërkimore të cilat na ndihmuan për ta realizuar studimin.

Hapi tretë përfshiu një studim të thellë të literaturës ndërkombëtare si dhe të burimeve të tjera dytësore, si studime të ngjashme lidhur me organizimin e orareve mësimore, më kufizimet e detyrueshme dhe të dëshiruara.

Hapi i katërt kishte të bënte me ndërtimin e instrumenteve konkretë të studimit. U ndërtua fillimisht një pyetësor i strukturuar, për mësimdhënësit e Shkollës së Mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec.

Hapi i pestë, kishte të bëjë me realizimin e studimit empirik. Hulumtimi në terren është realizuar nga fillimi i muajit prill 2017 dhe ka zgjatur plotë një muaj.

Hapi i gjashtë kishte të bënte me përpunimin e të dhënave. Të dhënat sasiore të mbledhura nëpërmjet procesit të anketimit, u përpunuan nëpërmjet programit Excel ndërsa të dhënat dhe informacionet e përftuara nga intervistat me mësimdhënësit e TIK-ut u përpunuan nëpërmjet analizës tematike.

Hapi i shtatë konsistoi në shkrimin e finale të temës së magjistraturës, ku u pasqyrua me kujdes e gjithë puna e realizuar përgjatë 6 hapave të mësipërm, si dhe u përmbledhën sugjerimet përkatëse.

Hapi i tetë: konsistoi në redaktimin shkencor dhe atë gjuhësor të temës së përfunduar.

3.5. Popullata dhe kampioni i zgjedhur

Megenëse studimi empirik i referohet mësimdhënësve të gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, popullatë është konsideruar numri i përgjithshëm i mësimdhënësve që i janë nënshtruar anketave të përgatitura enkas për këtë studim.

Për pjesën cilësore të studimit, që lidhej me procesin e intervistimit, u përdor kampioni i qëllimshëm. Një kriter i rëndësishëm për përzgjedhjen e personit të intervistuar, ishte që i intervistuari të ketë njohuri profesionale të TIK-ut. Intervista kemi realizuar, me drejtoreshën e DKA - Rahovec, me drejtoreshën e gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, me drejtorin e Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec.

Gjatë realizimit të intervistës u mbajt parasysh që:

- a. I intervistuari të përgjigjej sipas mënyrës së vet, me fjalët e veta.
- b. Vetë unë në rolin e hulumtuesit të eksploroja çështjet me të intervistuarin.
- c. Të nxitej i intervistuari në intervistim të shprehë sa më lirshëm dhe sa më natyrshëm opinionet e tij.
- d. Intervista të ishte fleksibël dhe e përshtatshme për të intervistuarin.

3.6. Instrumentet e kërkimit

Për mbledhjen e të dhënave me karakter parësor, nga procesi i anketimit, por edhe ai i intervistimit, u ngritën 2 instrumenta bazë, një pyetësor i strukturuar, i cili do të

plotësohej nga mësime të mesme “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, dhe një udhëzues interviste, i cili do të orientonte procesin e intervistimit me mësime të TIK-ut dhe me drejtorët e shkollave të sipërpërmendura, si dhe DKA - Rahovec.

3.7. Analiza e të dhënave

Kur flasim për analizën e të dhënave, duhet cekur se të dhënat që i kemi mbledhur nga realizimi i anketave i kemi përpunuar dhe analizuar në aplikacionin Excel, ku më pas kemi bërë edhe gjenerimin e grafikoneve duke i nxjerrë rezultatet e gjetura me përqindje. Edhe të dhënat nga intervistat, i kemi analizuar në mënyrë të thjeshtë pa përdorur ndonjë aplikacion apo pako, pasi që ato janë përgjigje të pyetjeve të hapura ku të intervistuarit kanë shprehur mendimin e tyre lidhur me pyetjet e parashtruara në udhëzues interviste.

KAPITULLI IV

4. DIZAJNIMI I PYETËSORIT DHE UDHËZUESIT TË INTERVISTAVE

4.1. Ndërtimi i pyetësit

Për ndërtimin e pyetësit kryesisht jemi mbështetur në titullin e punimit, qëllimin dhe hipotezat e këtij punimi, kështu që çdo pyetje ka pasur lidhshmëri me temën që e hulumtuam. Pyetësi i strukturuar që u përdor për mbledhjen e të dhënave përmban sy seksione.

Në seksionin e parë: *Të dhëna të përgjithshme*, janë paraqitur pesë pyetje të strukturuar, të cilat synojnë të marrin të dhëna në lidhje me gjininë, moshën, statusin martesor, vendbanimin dhe përvojën e punës. Kemi ndërtuar këto pyetje pasi që të gjitha kanë ndërlidhje me temën.

Seksioni i dytë: *Pyetjet lidhur me problemin e trajtuar në studim*, përmban 15 pyetje dhe ka si synim të mbledhë të dhëna në lidhje me njohjen e gjuhëve të huaja të të anketuarve, kush është përgjegjës për përpilimin e orareve mësimore, sa kohë merr përpilimi i orareve mësimore, a pësojnë ndryshime oraret mësimore pasi të jenë finalizuar dhe futur në përdorim ato, a janë përfshirë ndonjëherë në aktivitete që kanë të bëjnë me menaxhimin e shkollës, a kanë qenë ndonjë herë të angazhuar në përpilimin e orarit mësimor, a janë ballafaquar me probleme lidhur me organizimin e orëve, a evitohen shpejtë parregullsitë në orar nëse ndodh ndonjë ndryshim në të, a janë të kënaqur me mënyrën se si planifikohet dhe përgatitet orari mësimor, a shfaqen pakënaqësi në mesin e stafit lidhur me përcaktimin e orëve në oraret mësimore, cilat programe kompjuterike i njohin, sa janë të kënaqur me zhvillimin e TIK-ut në shkollë, a ka mësimdhënës të mjaftueshëm në shkollë për TIK-un krahasuar me numrin e nxënësve, a mendojnë se është e nevojshme bashkëpunimi me shkollat tjera për të përpiluar oraret mësimore.

4.2. Ndërtimi i udhëzuesit të intervistës

Udhëzuesi i intervistës përmbante pyetje të hapura e cila nuk u organizua në pjesë por vetëm në 17 pyetje të cilat tregojnë për numrin e mësimdhënësve të TIK-ut në shkollë, përgatitja e tyre shkollore, eksperiencia në TIK, përfshirja e tyre në menaxhimin e shkollës, detyrat menaxhuese që kryejnë, kush është përgjegjës në shkollë për përgatitjen e orareve,

me çfarë programi përgatitet orari mësimor, a kanë njohuri për softuerët të cilët janë të dizajnuara për oraret mësimore, cilët softuerë i njohin, a kanë bërë përpjekje për të implementuar në shkollë ndonjë softuer për orarin mësimor, cilat janë pengesat për të përdorur një sistem të tillë për oraret mësimore, cilat janë përparësitë që i ka shkolla për të implementuar softuerin, a stimulohen ndonjëherë për ndonjë punë shtesë që bëjnë në lidhje me TIK, si i shohin mundësitë për të ardhmen për të implementuar ndonjë softuer, sa është numri i nxënësve në shkollë, sa është numri i kompjuterëve në shkollë.

4.3. Validiteti i pyetësorëve dhe udhëzuesit të intervistave

Konsideroj se pyetësi është valid pasi që të dhënat e nxjerra nga pyetësorët kanë ndihmuar për të gjetur marrëdhëniet midis variablave të paraqitura në punim. Pyetjet në pyetësor të kuptueshme dhe lehtë të administruara.

Edhe udhëzuesi i intervistave konsideroj se është valid pasi që është përshtatur për të intervistuarin dhe ndihmon për gjetjen e të dhënave cilësore. Vlen përmendur se edhe pse në udhëzuesin e intervistave figurojnë 17 pyetje, ato pyetje i janë përshtatur secilit të intervistuar, prandaj, në raste të ndryshme jo të gjitha pyetjet kanë qenë të aplikueshme për të intervistuarit.


KAPITULLI V

5 ANALIZË E GJETJEVE EMPIRIKE

5.1 Analizë e të dhënave sasiore

Gjinia


Në hulumtimin e bërë për studimin tonë, 22% e të anketuarve i kanë takuar gjinisë femërore ndërsa 78% gjinisë mashkullore.



Grafikoni 1. Gjinia e të anketuarve

Mosha


Sa i përket moshës së të anketuarve, asnjë i intervistuar nuk është më nën 30 vjet. Pra, në alternativën 20 - 29 vjet kemi 0% të të anketuarve. 15% i takojnë moshës 30 - 35 vjet, 47% i takojnë moshës 36 - 45 vjet, 27% i takojnë moshës 46 - 55 vjet , ndërsa 11% i takojnë moshës 56 - 65 vjet.



Grafikoni 2. Mosha e të anketuarve

Statusi martesor


Ku kemi të bëjmë me pyetjen rreth statusit martesor kemi këto rezultate: 9 % e të anketuarve janë beqarë/e, ndërsa 91% e tyre janë të martuar. Alternativa “i/e ve” ka 0 %.



Grafikoni 3. Statusi martesor i të anketuarve

Vendbanimi


Sa i përket vendbanimit të të anketuarve, 38% e të anketuarve jetojnë në fshat ndërsa 62% në qytet.



Grafikoni 4. Vendbanimi i të anketuarve

Përvoja e punës


Sa i përket përvojës së punës, 15% e të anketuarve kanë përvojë pune 1 - 5 vjet, 27% kanë përvojë pune 6 - 10 vjet, 7% e të anketuarve kanë 11 - 20 vjet, 40% e të anketuarve kanë përvojë pune 20 - 30 vjet, ndërsa 11% e të anketuarve kanë përmbi 30 vjet përvojë pune.



Grafikoni 5. Përvoja e punës e të anketuarve

Njohja e gjuhëve të huaja


Sa i përket njohjes së gjuhëve të huaja, 27% e të anketuarve e njohin gjuhën angleze, 71% e flasin gjuhën serbe, 2% e flasin gjuhën boshnjake, ndërsa për gjuhë të tjera nuk kemi ndonjë specifikim.



Grafikoni 6. Njohja e gjuhëve të huaja

Kush është përgjegjës për përpilimin e orareve mësimore ?


Lidhur me pyetjen se kush është përgjegjës për përpilimin e orareve mësimore , kemi këto rezultate: Sipas të anketuarve, 40% prej tyre mendojnë se drejtoria është përgjegjëse për përpilimin e orareve mësimore, 13% e të anketuarve mendojnë se i tërë stafi është përgjegjës për përpilimin e orareve mësimore, ndërsa 47% e të anketuarve mendojnë se mësimdhënësit e TIK-ut janë përgjegjës për oraret mësimore.



Grafikoni 7. Përgjegjësit për përpilimin e orareve mësimore

Sa kohë merr përpilimi i orareve mësimore?


Se sa kohë merr përpilimi i orareve mësimore, kemi këto rezultate: 16% e të anketuarve mendojnë se orari mësimor merr kohë 2 ditë për tu përpiluar, 64% e të anketuarve mendojnë se orari mësimor merr kohë 5 ditë për tu përpiluar, ndërsa 20% e të anketuarve mendojnë se përpilimi i orareve mësimore kërkon 7 ditë kohë për tu realizuar.



Grafikoni 8. Koha për përpilimin e orareve mësimore

A pësojnë ndryshime oraret mësimore pasi të jenë finalizuar dhe futur në përdorim ato?


Lidhur me pyetjen nëse oraret mësimore pësojnë ndryshime pasi të jenë finalizuar ato, 18% e të anketuarve mendojnë se oraret pësojnë ndryshime pas finalizimit, 62% mendojnë se oraret mësimore nuk pësojnë ndryshime, ndërsa 20% e të anketuarve mendojnë se oraret mësimore pësojnë ndonjëherë ndryshime pas finalizimit.



Grafikoni 9. Ndryshimi i orareve mësimore pas finalizimit

A jeni përfshirë ndonjëherë në aktivitete që kanë të bëjnë me menaxhimin e shkollës?


Lidhur me pyetjen se a janë përfshirë të anketuarit ndonjëherë në aktivitete që kanë të bëjnë me menaxhimin e shkollës, 47% e të anketuarve deklarojnë shpesh, 40% e tyre deklarojnë ndonjëherë, ndërsa 13% deklarojnë asnjëherë.



Grafikoni 10. Përfshirja në aktivitete menaxheriale

A keni qenë ndonjë herë të angazhuar në përpilimin e orarit shkollor?


Bazuar në rezultatet e anketave, del se 78 % e të anketuarve shpesh herë janë angazhuar në përpilimin e orarit shkollor, 18% e tyre disa herë, ndërsa 45% e të anketuarve janë deklaruar asnjëherë.



Grafikoni 11. Angazhimi në përpilimin e orarit mësimor

A jeni ballafaquar me probleme lidhur me organizimin e orëve?


Sa i përket ballafaqimit me probleme lidhur me organizimin e orëve, 91% e të anketuarve janë deklaruar se janë ballafaquar me probleme lidhur me organizimin e orëve, ndërsa 9% janë deklaruar se nuk janë ballafaquar me probleme lidhur me organizimin e orëve.



Grafikoni 12. Ballafaqimi me probleme lidhur me organizimin e orëve

A evitohen shpejtë parregullsitë në orar nëse ndodh ndonjë ndryshim në të?


Se a evitohen shpejtë parregullsitë në orar nëse ndodh ndonjë ndryshim në të, kemi këto rezultatet: 65% e të anketuarve kanë deklaruar se ato evitohen shpejtë, 22% ato pengojnë procesin mësimor, ndërsa 13% mendojnë se shkolla shndërrohet në kaos.



Grafikoni 13. Evitimi i parregullsive në orare

A jeni të kënaqur me mënyrën se si planifikohet dhe përgatitet orari shkollor?


Lidhur me pyetjen se a jeni të kënaqur me mënyrën se si planifikohet dhe përgatitet orari shkollor, kemi këto rezultate. 76% e të anketuarve janë të kënaqur me mënyrën se si planifikohet orari mësimor, 18% e të anketuarve mendojnë se mundet edhe më mirë, 4% e të anketuarve nuk janë të kënaqur me mënyrën si planifikohet dhe përgatitet orari mësimor, ndërsa 2% e të anketuarve vlerësojnë se nuk u intereson kjo çështje.



Grafikoni 14. Kënaqshmëria me mënyrën se si përpilohet orari mësimor

A shfaqen pakënaqësi në mesin e stafit lidhur me përcaktimin e orëve në oraret mësimore?


Tek pyetja a shfaqen pakënaqësi në mesin e stafit lidhur me përcaktimin e orëve në oraret mësimore, kemi këto rezultate: 47% e të anketuarve pohojnë se shfaqen pakënaqësi, 4% e të anketuarve mohojnë këtë pakënaqësi, ndërsa 49% deklarojnë se zakonisht shfaqen pakënaqësi në mesin e stafit lidhur me përcaktimin e orëve në oraret mësimore.



Grafikoni 15. Pakënaqësitë me mënyrën se si përpilohet orari mësimor

Cilat programe kompjuterike i njihni?


Të anketuarit kanë njohuri të përgjithshme lidhur më programet kompjuterike. Këtu kemi një mesatare të njohurive të programeve kompjuterike në mesin e të anketuarve. Pra, përqindja është e barabartë tek rezultatet për njohuritë programeve kompjuterike.



Grafikoni 16. Programet kompjuterike që njohin të anketuarit

Sa jeni të kënaqur me zhvillimin e TIK-ut në shkollë?


Në pyetjen se sa jeni të kënaqur me zhvillimin e TIK-ut në shkollë, 9% e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur, 27% të kënaqur, 44% e të anketuarve mendojnë se ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm, ndërsa 20% e të anketuarve janë të pakënaqur.



Grafikoni 17. Kënaqësia me zhvillimin e TIK-ut në shkollë

A ka mësimdhënës të mjaftueshëm në shkollë për TIK krahasuar me numrin e nxënësve?


Lidhur me pyetjen a ka mësimdhënës të mjaftueshëm në shkollë për TIK krahasuar me numrin e nxënësve, kemi këto rezultate: 22% konsiderojnë se numri i tyre është i vogël, 67% mendojnë se numri i tyre është aq sa i nevojiten, ndërsa 11% konsiderojnë se numri i tyre është i madh.



Grafikoni 18. Numri i mësimdhënësve të TIK-ut në shkollë

A mendoni se është e nevojshme bashkëpunimi me shkollat tjera për të përpiluar oraret mësimore?

Pyetja e fundit kishte të bëjë me nevojshmërinë e bashkëpunimit me shkollat tjera për të përpiluar oraret mësimore, 40% deklarohen pozitivisht me po, 40% deklarohen negativisht me jo, ndërsa 20 % me alternativën ndoshta.



Grafikoni 19. Bashkëpunimi me shkollat tjera për përpilimin e orareve mësimore

5.2 Analizë e të dhënave cilësore

Sa i përket të dhënave cilësore, nga intervista e realizuar kemi këto të dhëna:

Gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, nga gjithsej 45 mësime dhënë, 4 prej tyre kanë mësime dhënë të TIK-ut. Vetëm njëri prej tyre ka të mbaruar Fakultetin e Informatikës, ndërsa tre të tjerët kanë Fakultetin e Inxhinierisë. Një prej këtyre profesorëve ka 16 vjet përvojë pune në TIK, dy mësime dhënë kanë 3 vjet përvojë pune, ndërsa njëri është me 5 vjet përvojë pune.

Në menaxhimin e përgjithshëm të shkollës, asnjëri prej tyre nuk është i përfshirë në menaxhimin e shkollës. Përgjegjës për përpilimin e orareve mësimore është njëri prej mësime dhënëve të TIK-ut.

Orari mësimor në këtë shkollë, përgatitet me programin aSc Timetable. Mësime dhënësit e TIK-ut kanë njohuri bazë vetëm për këtë softuer, i dizajnuar për oraret mësimore. Mësime dhënësit e TIK-ut kanë informata se ka edhe softuerë që ofrohen falas për programe mësimore, por nuk e kanë diskutuar këtë çështje me menaxhmentin e shkollës.

Sipas tyre, pengesat për të përdorur një sistem të tillë për oraret mësimore janë kryesisht në natyrës financiare. Përparësitë që i ka shkolla për të implementuar softuerin qëndrojnë në faktin se ekziston vullneti për të punuar me këtë program. Mirëpo, këta mësime dhënë të TIK-ut nuk stimulohen ndonjëherë për ndonjë punë shtesë që bëjnë në lidhje me TIK.

5.3. Analiza e korrelacionit

Në këtë hulumtim është bërë edhe analiza e korrelacionit ku janë gjetur disa ndërlidhje (cross - relation) ndërmjet variablave.

Në rezultatet e dala është gjetur korrelacion sinjifikant i variablave në mes të mësimeve që jetojnë në qytet dhe deklarimit të tyre se kanë njohuri për softuerët për programet mësimore, që tregon se sa më i madh është numri i mësimeve që jetojnë në qytet, aq më e madhe është njohuria e stafit mësimor për softuerët për programet mësimore.

Po ashtu të dhënat e hulumtimit tonë tregojnë se mësimeve që i përkasin gjinisë mashkullore kanë më shumë njohuri për softuerët e programeve mësimore se sa mësimeve e gjinisë femërore, që nënkupton se softuerët e programeve mësimore janë më atraktiv tek meshkujt se sa tek femrat.

Rezultatet e dala nga hulumtimi tregojnë për një korrelacion sinjifikant në mes të përvojës së punës së mësimeve dhe afinitetit për hartimin e programeve mësimore përmes softuerëve, që tregon se sa më e madhe është përvoja e mësimeve në shkollë, aq më e lartë është përgatitja e tyre për të hartuar programe shkollore me softuerë.

Është me rëndësi të ceket edhe korrelacioni sinjifikant që është gjetur në mes të mësimeve që njohin gjuhën angleze dhe gatishmërisë së tyre për të hartuar programe mësimore me softuerë, që nënkupton se sa më e madhe që është shkalla e njohjes së gjuhës angleze tek mësimeve, aq më e lartë është edhe mundësia për përgatitjen apo hartimin e programeve mësimore përmes softuerëve.

KAPITULLI VI

6. DISKUTIME

6.1. Diskutime lidhur me analizat e të dhënave sasiore

Në kapitullin e mësipërm paraqitëm të dhënat që i kemi nxjerrë nga të dhënat sasiore dhe cilësore (anketa dhe intervistat). Bazuar në ato rezultate, si më poshtë paraqesim diskutimin e të dhënave sasiore dhe cilësore.

Hulumtimi tregon se përqindja më e madhe e mësimdhënësve i takon gjinisë mashkullore (78%). Një fakt është vërejtur se në këtë shkollë asnjë mësimdhënës nuk është nën moshën 30 vjeçare. Madje 3 mësimdhënës janë edhe para pensionimit të tyre.

Sa i përket statusit martesor, është i vogël numri i të pamartuarve – beqarëve (9%), ndërsa pjesa dërmuese e të anketuarve kanë krijuar familje. Mësimdhënësit jetojnë në qytet, me një përqindje mesatare që jetojnë në fshat (38%). Mësimdhënësit përveç gjuhës shqipe (si gjuhë amtare) flasin rrjedhshëm edhe gjuhën serbe , ndërsa 27% prej tyre kanë njohuri të gjuhës angleze.

Një pjesë e mësimdhënësve mendojnë se drejtoria e shkollës është përgjegjëse për hartimin e orareve mësimore, ndërsa pjesa tjetër mendojnë se mësimdhënësit e TIK-ut duhet të angazhohen në këtë proces.

Shumica e mësimdhënësve mendojnë se orari mësimor duhet të marrë së paku 5 ditë kohë për tu përpiluar dhe për tu finalizuar. Shumica, madje, mendojnë se pas finalizimit, orari mësimor nuk pëson ndryshime.

Nga përgjigjet e të anketuarve kemi konstatuar se ata në një farë mase janë të përfshirë në aktivitete që kanë të bëjnë me menaxhimin e shkollës. Ndërsa një numër i madh i të anketuarve konstaton se kanë qenë të angazhuar në përpilimin e orarit mësimor.

Në të dhënat e nxjerra, është vënë re, se të anketuarit (91%) janë ballafaquar me probleme lidhur me organizmin e orëve. Mësimdhënësit kanë hedhur në dritë faktin se parregullsitë në orare mësimore evitohen shpejtë. Mësimdhënësit janë kryesisht të kënaqur me mënyrën se si planifikohet dhe përgatitet orari shkollor. Në mënyrë të

barabartë janë rezultatet e pyetjes a shfaqen pakënaqësi në mesin e stafit lidhur me përcaktimin e orëve në oraret mësimore ku mësimdhënësit kanë mendime në këto dy rrafshë me përqindje të barabartë. Të anketuarit kanë njohuri të përgjithshme lidhur me programet kompjuterike. Këtu kemi një mesatare të njohurive të programeve kompjuterike në mesin e të anketuarve. Pra, përqindja është e barabartë tek rezultatet për njohuritë programeve kompjuterike.

Është nxjerrë edhe një konstatim nga anketat se lidhur me shkallën e kënaqësisë me zhvillimin e TIK-ut në shkollë, ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Po ashtu, është konstatuar se numri i mësimdhënësve të TIK-ut është i mjaftueshëm për numrin e përgjithshëm të nxënësve në shkollë (950:4). Sa i përket nevojës së bashkëpunimit me shkollat tjera për të përpiluar oraret mësimore, këtu kemi një rezultat relativ pasi të anketuarit kanë dhënë përgjigje “Po” dhe “Jo” me përqindje të njëjtë.

6.2. Diskutime lidhur me analizat e të dhënave cilësore

I intervistuari, përmes intervistës, ka ndikuar në këtë hulumtim që të krijohet një diskutim bazë dhe i vlefshëm lidhur me disa karakteristika të Gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, lidhur me temën që e kemi studiuar.

Bazuar në përgjigjet, është konstatuar se mësimdhënësit e TIK-ut kanë vullnet për të zhvilluar më tutje hapat teknologjike për krijimin e orareve mësimore, mirëpo ata, për fat të keq, nuk stimulohen në asnjë formë.

Edhe pse numri i mësimdhënësve të TIK-ut, krahasuar me numrin e nxënësve, raporti 4:950, për ne si studiues është paksa skeptik, në intervistë është thënë se numri i mësimdhënësve të TIK-ut është i mjaftueshëm për numrin e nxënësve të kësaj shkolle. Mirëpo nëse e kemi parasysh faktin se sa ka sot rëndësi lënda e TIK-ut në shkollë, atëherë numri i orëve në javë (vetëm një orë për një paralele), është shumë i vogël krahasuar me kërkesat që i kërkon por edhe i imponon koha.

Është shumë pozitive fakti që kjo shkollë e përpilon orarin mësimor me aSc Timetable, megjithëse, shkolla ende nuk është e gatshme të financojnë ndonjë program të licencuar për përgatitjen e orareve mësimore, por e përdor aSc Timetable, i cili ofrohet falas.

6.3. Krahasim i rezultateve të punimit me rezultatet e hulumtimit me shkollë tjetër

Në hulumtimin tonë kemi bërë krahasim me Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec. Sa i përket numrit të nxënësve, krahasuar me gjimnazin "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec ka gjithsej 350 nxënës, që do të thotë se ka 600 nxënës më pak se gjimnazi "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec.

Meqenëse Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec, ka një numër më të vogël të nxënësve, (600 nxënës më pak), kjo shkollë ka vetëm një mësimdhënës të TIK-ut, që nënkupton se ka dy mësimdhënës të TIK-ut më pak se sa gjimnazi "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec.

Nëse bëjmë krahasim lidhur me përgatitjen shkollore të mësimdhënësve të TIK-ut në këto dy shkolla, atëherë gjejmë se në Shkollën e Mesme të e Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec, përgatitja shkollore e mësimdhënësit të TIK-ut është bachelor i shkencave kompjuterike, ndërsa ka përvojë pune vetëm një vjet në këtë shkollë. Ndërsa në gjimnazin "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, një mësimdhënës është me përgatitje adekuate, pra bachelor i informatikës, ndërsa dy të tjerët kanë këtë përgatitje shkollore: inxhinier i elektros dhe master i makinerisë.

Përderisa gjimnazi "Xhelal Hajda – Toni" posedon 32 kompjuterë (Pentium 4), 28 prej të cilëve janë në gjendje të rregullt, ndërsa 4 janë jashtë funksionit, Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec, posedon 10 kompjuterë, tetë prej të cilëve janë në gjendje të rregullt.

Në gjimnazin "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, mësimdhënësit e TIK-ut përgatisin orarin mësimor me program të automatizuar, ndërsa në Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec, mësimdhënësi i TIK-ut është shumë pak i inkuadruar në këtë proces apo nuk është fare. Po në këtë shkollë përgjegjës për përgatitjen e orareve është një mësimdhënës i cili e bën orarin në mënyrë manuale. Ai e përgatitë orarin, së pari nëpër letra të bardha (Formati A4) e më pas finalen e paraqet në letër hameri. Mësimdhënësit e kësaj shkolle kanë dëgjuar për softuerët të cilët janë të dizajnuara për oraret mësimore por nuk kanë njohuri se cilët janë ata softuerë.

Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec, nuk ka bërë asgjë konkrete për të implementuar në shkollë ndonjë softuer për orarin mësimor. Edhe pse ka softuerë që ofrohen falas për programe mësimore, kjo çështje nuk është diskutuar asnjëherë me menaxhmentin e shkollës.

Sipas përfaqësuesve të kësaj shkolle, pengesat për të përdorur një sistem të tillë për oraret mësimore konsistojnë në mungesën e njohurive rreth programeve përkatëse. Në këtë shkollë mësimdhënësit e TIK-ut nuk stimulohen ndonjëherë për ndonjë punë shtesë që bëjnë në lidhje me TIK, ndërsa shumë pak i shohin mundësitë për të ardhmen për të implementuar ndonjë softuer.

6.4. Analizë krahasuese

Bazuar në këto të dhëna krahasuese, edhe pse shkollat gjenden në të njëjtin qytet, konsiderohet se gjimnazi "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec është shumë më i avancuar sa i përket aplikimit të TIK-ut në menaxhimin e shkollave.

Arsyeja qëndron në faktin se kjo shkollë ka më shumë kompjuterë se sa Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec. Arsye tjetër pse gjimnazi "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec është më i avancuar në këtë aspekt është sepse në këtë shkollë ka më shumë mësimdhënës të TIK-ut, por edhe pse kjo çështje është diskutuar me menaxhmentin e shkollës.

Po ashtu Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec ka vetëm një mësimdhënës të TIK-ut i cili nuk ka asnjë njohuri rreth softuerëve për oraret mësimore, ndërsa gjimnazi "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, ka tre mësimdhënës të TIK-ut por edhe janë të informuar mirë rreth këtyre softuerëve, disa prej të cilëve mund të përdoren edhe falas.

Nga e tëra kjo mund të konkludohet se gjimnazi "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, krahasuar me shkolla të tjera, ka avancuar mjaft mirë me aplikimin e softuerëve për përgatitjen e orarit mësimor si dhe vazhdimisht është e informuar rreth përditësimeve që bëhen në këtë softuerë, që në të ardhmen mund të avancohen edhe më shumë.

6.5. Verifikimi i hipotezave

Hipoteza e përgjithshme:

H0. Shkolla e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, posedon mundësitë e TIK-ut për një menaxhim të suksesshëm të orareve mësimore .

Kjo hipotezë verifikohet për faktin se hulumtimet tona empirike kanë konstatuar se shkolla ka kapacitete të burimeve njerëzore por edhe infrastrukturë të mirë të teknologjisë për menaxhuar suksesshëm oraret mësimore.

Hipotezat e veçanta:

H1. Shkolla e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, ka staf të kualifikuar të cilët kanë njohuri të mjaftueshme të Teknologjisë Informative, të cilët po që se stimulohen do të ndikonin në menaxhimin e suksesshëm të orareve mësimore përmes TIK-ut.

Hipoteza e parë është testuar pasi që shkolla ka mësimdhënës të TIK-ut të cilët kanë vullnet për të menaxhuar në mënyrë të suksesshme oraret mësimore, porse mungon stimulimi i tyre qoftë ai material apo në ndonjë formë tjetër.

H2. Shkolla e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec posedon pajisje të mjaftueshme të Teknologjisë Informative, të nevojshme për një menaxhim të suksesshëm të orareve mësimore.

Kjo hipotezë është verifikuar duke u bazuar në analizat cilësore ku vlerësohet se shkolla posedon pajisje të mjaftueshme të Teknologjisë Informative.

H3. Në Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec mungon stimulimi për stafin me përgatitje të mjaftueshme të TIK-ut, të cilët do të jepnin kontributin e tyre në menaxhimin e orareve mësimore.

Edhe hipoteza e tretë verifikohet pasi që mësimdhënësit janë shprehur qartë se ata nuk stimulohen në asnjë formë për të dhënë kontributin e tyre profesional në menaxhimin e orareve mësimore.

6.6. Vlefshmëria e studimit

Megenëse kemi realizuar hulumtim origjinal, duke përdorur të dhëna parësore (anketat me mësimdhënës, intervista me mësimdhënës të TIK-ut), dhe të dhëna dytësore literatura bashkëkohore dhe e mëhershme nga autorë të huaj dhe vendas, konsideroj se punimi ka një vlefshmëri shkencore pasi që në mënyrë të qartë pasqyron situatën aktuale lidhur me aplikimin e TIK-ut në menaxhimin e Shkollës së Mesme “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Ky kontribut shkencor mund të radhitet në mesin e kontributeve të tjera shkencore lidhur me këtë temë, por gjithashtu mundet edhe të shërbejë si pikënisje apo si referencë për studiuesit tjerë të kësaj fushe.

PËRFUNDIMI

Me orar nënkuptojmë orët e caktuara kur nis ose kryhet diçka apo brenda të cilave zhvillon veprimtarinë një institucion (në rastin tonë institucionet shkollore). Pra, orari është një pasqyrë ku shënohen orët kur bëhet diçka, vendi ku bëhet, radha e veprimeve si dhe personat (mësimdhënësit) përgjegjës për atë veprimtari.

Sipas Wren, orari është shpërndarja, në varësi të kufizimeve, e burimeve të dhëna për objektet që vendosen në kohë - hapësirë, në mënyrë të tillë që të arrijë në mënyrë sa më të kënaqshme objektivat e dëshiruara.

Problemi i përgjithshëm i orareve vjen në shumë forma të paraqitjes, përfshirë orarin e infermierëve, orarin e sporteve, orarin e transportit publik, orarin shkollor, e të tjera. Orari shkollor është caktimi i vazhdueshëm i kohës, klasave (kabineteve), mësimdhënësve, nxënësve, për të organizuar aktivitetet në mënyrën më të kënaqshme sipas preferencave të nxënësve, mësimdhënësve si dhe vet shkollës.

Komponentët që përfshihen në orarin shkollor janë:

- Aktivitetet (orët mësimore, orët praktike apo aktivitetet tjera në klasë);
- Koha (ditët, javët apo muajt brenda një gjysmë-vjetori);
- Burimet (mësimdhënësit, dhomat e mësimi (kabinete) laboratorët);
- Klasa (grupi i nxënësve që marrin pjesë në aktivitete të njëjta).

Oraret mësimore zakonisht i përmbahen dy kufizimeve që janë të patjetërsueshme. Ato janë: kufizimet e detyruara dhe kufizimet e dëshiruara. Këto dallojnë shumë nga njëra - tjetra. Kufizimet e detyruara janë kufizime të cilat duhet të përmbushen domosdo në orar me qëllim që të jetë orari i realizueshëm. Kufizimet e detyruara duhet të përmbushen në çdo rrethanë. Për shembull, asnjë nxënës nuk mundet të ketë dy lëndë mësimore ose dy provime në të njëjtën kohë.

Kufizimet e dëshiruara përcaktojnë cilësinë e orarit. Këto janë zakonisht kontradiktore, dhe si të tilla është e pamundur për t'i përmbushur të gjitha kufizimet e dëshiruara.

Përgatitja e orareve mësimore me një numër të madh orësh mësimore, për një numër të madh nxënësish, një numër klasash, është proces mjaft kompleks, i cili shpesh herë

është zgjidhur në mënyrë manuale nga stafi menaxhues i shkollës, edhe pse rezultatet nuk kanë qenë çdo herë të kënaqshme.

Në kalendarin e shkollës, kërkohet të planifikohen një sërë takimesh mes nxënësve dhe mësimeve. Oraret që rezultojnë duhet të jenë të realizueshme dhe të pranueshme për të gjithë njerëzit e përfshirë. Meqenëse shkollat ndryshojnë në politikat e tyre arsimore, problemi i orarit shkollor ndodh në disa variacione. Megjithatë, një grup entitetesh dhe kufizimet e detyruara mes tyre janë të zakonshme në këto ndryshime.

REKOMANDIMET

Që oraret mësimore të jenë funksionale, të mos shkaktojnë shpenzime në burime njerëzore dhe infrastrukturë, por gjithçka të përdoret në mënyrë racionale, japim këto rekomandime për secilën kategori.

Rekomandime për hartuesit e programeve shkollore

Rekomandime për klasat (grupe e nxënësve):

- Çdo klasë duhet të përfshihet në orar;
- Duhet të bëhen oraret për klasat, për numrin e caktuar të orëve mësimore, për secilën lëndë lidhur me periudhën mësimore (zakonisht përcaktohen me javë);
- Klasave nuk duhet t’iu ndërrohet orari shpesh për shkak të mospërputhjeve me klasat tjera;
- Ka raste specifike kur klasat mund të bashkohen me një klasë tjetër për qëllime të caktuara mësimore. Kjo mund të ndodh vetëm tek paralelet e njëjta (klasat e një viti të njëjtë).

Rekomandime për mësimdhënësit:

- Mësimdhënësve nuk duhet t’iu ndërrohet orari brenda një gjysmë-vjetori.
- Mësimdhënësve duhet të iu caktohet orari sipas fondit të orëve të parapara me rregullore, me secilën klasë brenda një gjysmë-vjetori.
- Ka mundësi që, mësimdhënësit, për shkak të detyrimeve në shkollë mos të arrijnë që, të mbajnë orë të caktuara edhe në ndonjë shkollë tjetër.
- Mësimdhënësve duhet t’iu ndahen orët sipas kritereve të lejuara nga MASHT.
- Mësimdhënësve iu lejohet të mbajnë mësim në shkollat tjera (paralele të ndara) në rastet se nuk i kanë të plota fondin e orëve të obliguara për një mësimdhënëse.

Rekomandime për dhomat e mësimi (kabinetet):

- Kapaciteti i dhomës nuk duhet të tejkalojë numrin e nxënësve.
- Të gjitha dhomat e mësimi duhet të jenë të shfrytëzueshme apo në shfrytëzim.

- Disa lëndë kërkojnë dhoma të veçanta mësimi (kabinete, laboratorë, sala të edukatës fizike etj.).

Rekomandime të tjera:

- Krijimi i orarit mësimor përfshin caktimin e klasave, mësimdhënësve si dhe dhomave mësimore në një afat të caktuar kohor, në atë mënyrë që asnjë mësimdhënës, asnjë klasë apo asnjë dhomë mësimi mos të përplasen brenda një orari. Për shembull, nëse mësimdhënësi duhet t'i mbajë dy orë në javë, duhet të rregullohet orari asisoj që t'i evitohet përplasjet e mundshme.
- Një klasë përbehet nga një numër i caktuar i nxënësve. Duhet pasur parasysh se përcaktimi i numrit të nxënësve në një klasë është fikse, klasat janë të shkëputura nga njëra tjetra, kështu që nuk krijohen mospërputhshmëri.
- Detyra e kombinimit të klasës, mësuesit dhe dhomës, duhet të përcaktohet në formë tabelore, si një operacion i veçantë. Forma tabelare, krijohen në pajtim me njohuritë për klasa të ndryshme dhe mësimdhënës të ndryshëm, si dhe informata për disponueshmërinë e klasës.

BIBLIOGRAFIA

1. Abramson, D. (1991). Constructing school timetables using simulated annealing: sequential and parallel algorithms. *Management Science*, 37(1), 98–113.
2. Alvarez-Valdes, R. (2002). A tabu search algorithm for assigning teachers to courses. *TOP: An Official Journal of the Spanish Society of Statistics and Operations Research*, 10(2), 239–259.
3. Asratian, A.S., & de Werra, D. (2002). A generalized class-teacher model for some timetabling problem. *European Journal of Operational Research*, 143, 531-542.
4. Beligiannis, G. N., Moschopoulos, C. N., Kaperonis, G. P., & Likothanassis, S. D. (2008). Applying evolutionary computation to the school timetabling problem: the Greek case. *Computers and Operations Research*, 35, 1265–1280.
5. Birbas, T., Daskalaki, S., Housos, E. (1999). Rescheduling Process of a School Timetable: The Case of the Hellenic High Schools & Lyceums. *Punim shkencor në Konferencën e 5 Ndërkombëtare në Institutin e Shkencave Vendimmarrëse, Athinë, Greqi*.
6. Burke, E. (1997). *Proc. of the 2nd Int. Conf. on the Practice and Theory of Automated Timetabling, Lecture Notes in Computer Science*. Springer-Verlag.
7. Burke, E. (2007). A Graph-Based Hyper-Heuristic for Educational Timetabling Problems. *European Journal of Operational Research*, 176, 177-192.
8. Colorni, A. (1998). Metaheuristics for high school timetabling. *Computational Optimization and Applications*, vol. 9, Nr. 3, 275–298.
9. Cooper, B (1993). The solution of real instances of the timetabling problem. *The Computer Journal*, vol. 36, Nr. 7, 645–653.
10. D. Abramson J. Abela. (1992, Shkurt). A Parallel Genetic Algorithm for Solving the School Timetabling Problem. Retrieved 4 30, 2017.
11. De Haan (2004). Timetabling in dutch secondary schools. Masters Thesis, University of Twente.
12. Eikelder, H.M.M. ten, & Willemen, R.J. (2001). Some Complexity Aspects of Secondary School Timetabling Problems. *Springer-Verlag*, Nr.2079, 3–17.

13. Gerhard Post; Samad Ahmadi; Sophia Daskalaki; Jeffrey H. Kingston; Jari Kyngas; Cimmo Nurmi; David Ranson. (2010). An XML format for benchmarks in High School Timetabling. *Ann Oper Res*, 194, 385–397. doi:DOI 10.1007/s10479-010-0699-9.
14. Gotlieb, C. (1963). The construction of class-teacher timetables. in IFIP congress 62, C. M. Popplewell. North-Holland, 73–77.
15. Kasumi, B. (2005). *ECDL - European Computer Driving Licence*. Prishtinë: Smart Bits.
16. Kostallari, A. (1981). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe N-ZH*. Prishtinë: Rilindja.
17. Learning and Teaching Scotland, (2006). www.ltscotland.org.uk/ictineducation/professionaldevelopment/management/timetabling.
18. Limbran Sampebatu; Aries Kamolan. (2016). Timetable management using genetic algorithms. *Jurnal Ilmiah Widya Teknik*, 15(2).
19. Marte, M. (2012). *Models and Algorithms for School Timetabling –A Constraint-Programming Approach*. Munchen: an der Fakultät für Mathematik, Informatik und Statistik der Ludwig-Maximilians-Universit - Munchen.
20. Masri Ayob; Abdul Razak Hamdan; Salwani Abdullah; Zalinda Othman; Mohd Zakree, et al. (2011). Intelligent Examination Timetabling Software. *Procedia Social and Behavioral Sciences*, 600-608.
21. Paechter, B (1995). Proc. of the 1st Int. Conf. on the Practice and Theory of Automated Timetabling, Lecture Notes in Computer Science. Springer-Verlag.
22. Pillay, N. (n.d.). An Overview of School Timetabling Research.
23. Post, G, et al. (2008). An XML format for benchmarks in high school timetabling. In Proceedings of the 7th international conference on the practice and theory of automated timetabling (PATAT 2008), Montreal. http://w1.cirreht.ca/~patat2008/PATAT_7_PROCEEDINGS/Papers/Post-WD2a.pdf.
24. Schaerf, A. (1999). Local search techniques for large high-school timetabling problems. IEEE Transactions on Systems, Man, and Cybernetics - Part A: Systems and Humans. Volumi: 29, Nr.4, 368-377.
25. Schaerf, A. (1995). A survey of automated timetabling”, Tech. Rep. CS-R9567, CWI, Amsterdam, The Netherlands, 1995, To appear in Artificial Intelligence Review.

26. Valouxis, C., Housos, E. (2003). A column generation approach for the timetabling problem of Greek high schools. *Journal of Operational Research Society*, 54, 230–238.
27. Wilke, P., & Ostler, J. (2008). Solving the school timetabling problem using tabu search, simulated annealing, genetic and branch & bound algorithms. Montreal. http://w1.cirreht.ca/~patat2008/PATAT_7_PROCEEDINGS/Papers/Wilke-WD2c.pdf.
28. Wren, A. (1996). Scheduling, timetabling and rostering — A special relationship- Practice and Theory of Automated Timetabling. PATAT 1995. (R. P. Burke E., Ed.) *Lecture Notes in Computer Science*, 1153. doi:10.1007/3-540-61794-9_51
29. Wren, A. (1996). Scheduling, timetabling and rostering — A special relationship? Practice and Theory of Automated Timetabling. PATAT 1995. (R. P. Burke E., Ed.) *Lecture Notes in Computer Science*, 1153. doi:10.1007/3-540-61794-9_51
30. Yoshikawa, M. (1996). A constraint-based high school scheduling system”, *IEEE Expert*, vol. 11, Nr. 1, 63–72.

WEBLIOGRAFIA

1. <http://lalescu.ro/liviu/fet>.
2. <http://www.asctimetables.com>.
3. <http://www.mimosasoftware.com>.
4. <http://www.primetimetable.com/#intro&id=09c6044a-1a05-4f99-b9a6-fa7f3cc8a0f9>.
5. <http://www.proclassonline.com>.
6. <http://www.school-timetabling.com>
7. <http://www.school-timetabling.com>.
8. <http://www.timetabler.com>.
9. <http://www.wisetimetable.com/about.htm>.

SHTOJCA 1: PYETËSOR

Ky pyetësor, përbën një instrument për studimin empirik të punimit të masterit “Aplikimi i TIK-ut në menaxhimin e shkollave (Analizë e softuerëve për orare)”, me autor Sinan Dermala. Ai u drejtohet mësime dhënëse të Shkollës së Mesme “Xhelal Hajda – Toni” të Rahovecit. Duke ju siguruar për konfidencialitetin e të dhënave, ju garantoj se ato do të përdoren vetëm për qëllime studimore. Faleminderit për zbatimin!

Seksioni 1: Të dhëna të përgjithshme

1	Gjinia	a) Femër b) Mashkull
2	Mosha	a) 20 -30 vjeç b) 31-40 vjeç c) 41-50 vjeç d) 51- e më shumë vjeç
3	Statusi martesor	a) Beqar/e b) I/e martuar c) I/ e ndarë d) I/e ve
4	Vendbanimi	a) Fshat b) Qytet
5	Përvoja e punës	a) 1- 5 vjet b) 6-10 vjet c) 11-20 vjet d) 20-30 vjet e) 30 e më shumë vjet

Seksioni 2: Pyetjet lidhur me problemin e trajtuar në studim

6	Njohja e gjuhëve të huaja	a) Gjuhë angleze b) Gjuhë serbe c) Gjuhë boshnjake d) Të tjera
7	Kush është përgjegjës për përpilimin e orareve mësimore ?	a) Drejtoria b) I tërë stafi c) Mësime dhënëse të TIK-ut
8	Sa kohë merr përpilimi i orareve mësimore?	a) 2 ditë b) 5 ditë c) 7 ditë

9	A pësojnë ndryshime oraret mësimore pasi të jenë finalizuar dhe futur në përdorim ato?	a) PO b) JO c) Ndonjëherë
10	A jeni përfshirë ndonjëherë në aktivitete që kanë të bëjnë me menaxhimin e shkollës?	a) Shpesh b) Ndonjëherë c) Asnjëherë
11	A keni qenë ndonjë herë të angazhuar në përpilimin e orarit mësimor?	a) Po, shpesh herë b) Disa herë c) Asnjëherë
12	A jeni ballafaquar me probleme lidhur me organizimin e orëve?	a) Po b) Jo
13	A evitohen shpejtë parregullsitë në orar nëse ndodh ndonjë ndryshim në të?	a) Ato evitohen shpejtë b) Ato pengojnë procesin mësimor c) Shkolla shndërrohet në kaos
14	A jeni të kënaqur me mënyrën se si planifikohet dhe përgatitet orari mësimor	a) Jam i/e kënaqur b) Mundet edhe më mirë c) Nuk jam e kënaqur d) Nuk më intereson
15	A shfaqen pakënaqësi në mesin e stafit lidhur me përcaktimin e orëve në oraret mësimore?	e) Po f) Jo g) Zakonisht
16	Cilat programe kompjuterike i njihni?	a) Word b) Excel c) Outlook d) Internet Explorer e) Power Point f) Të tjera
17	Sa jeni të kënaqur me zhvillimin e TIK-ut në shkollë?	a) Plotësisht i/e kënaqur b) I /e kënaqur c) Ka nevojë për zhvillim të mëtejme d) i/e pakënaqur
18	A ka mësimdhënës të mjaftueshëm në shkollë për TIK krahasuar me numrin e nxënësve?	a) Numri i tyre është i vogël b) Numri i tyre është aq sa nevojiten c) Numri i tyre është i madh
19	A mendoni se është e nevojshme bashkëpunimi me shkollat tjera për të përpiluar oraret mësimore?	a) Po b) Jo c) Ndoshta
20	Çfarë do të shtonit?	

SHTOJCA 2: UDHËZUES INTERVISTE

Ky udhëzues interviste, përbën një instrument për studimin empirik të punimit të masterit “Aplikimi i TIK-ut në menaxhimin e shkollave (Analizë e softuerëve për orare)”, me autor Sinan Dermal. Ai i drejtohet njërit prej mësimdhënësve të TIK-ut, (i vetmi me përgatitje shkollë nga fusha e informatikës) në Shkollën e Mesme “Xhelal Hajda – Toni” të Rahovecit. Duke ju siguruar për konfidencialitetin e të dhënave, ju garantoj se ato do të përdoren vetëm për qëllime studimore. Faleminderit përzemërsisht për ndihmën!

Pyetje:

1. Sa mësimdhënës të TIK-ut ka shkolla?
2. Cila është përgatitja e tyre shkollë?
3. Sa kanë eksperiencë në TIK?
4. Sa janë të përfshirë në menaxhimin e shkollës?
5. Çfarë detyrash menaxhuese kryejnë?
6. Kush është përgjegjës në shkollë për përgatitjen e orareve?
7. Me çfarë programi përgatitet orari mësimor?
8. A keni njohuri për softuerët të cilët janë të dizajnuara për oraret mësimore?
9. Cilët softuerë i njihni?
10. A keni bërë përpjekje për të implementuar në shkollë ndonjë softuer për orarin mësimor?
11. Ka edhe softuerë që ofrohen falas për programe mësimore. A e keni diskutuar këtë çështje me menaxhmentin e shkollës?
12. Cilat janë pengesat për të përdorur një sistem të tillë për oraret mësimore?
13. Cilat janë përparësitë që i ka shkolla për të implementuar softuerin?
14. A stimuloheni ndonjëherë për ndonjë punë shtesë që bëni në lidhje me TIK?
15. Si i shihni mundësitë për të ardhmen për të implementuar ndonjë softuer?
16. Sa është numri i nxënësve në shkollë?
17. Sa është numri i kompjuterëve në shkollë?

SHTOJCA 3: DEKLARATA E LEKTORIT


QENDRA PER LEKTORIN
PRISTINE

Telefoni: +386 49 377 438, e-mail adresa: shukrie.rama@gmail.com


Unë, Shukrije Rama, me profesion Lektor, nën përgjegjësi morale dhe materiale, me datë 7 qershor, 2017, jap këtë:

DEKLARATË

Me të cilën deklaroj se kam lekturuar temën e Masterit me titull "Aplikimi i TIK-ut në menaxhimin e shkollave (Analizë e softuerëve për orare)", të kandidatit Sinan DERMALA.

Prishtinë, 07. 06. 2017



LEKTORE
Shukrije RAMA


SHTOJCA 4. LEJA NGA DKA - RAHOVEC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

	9.06.2017
Referenc-ë	07/ 695
Për/Za/To:	z. Sinan Dërmala
CC:	Aplikimi i TIK-ut në menaxhimin e orarve shkollore
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria Komunale të Arsimit - Rahovec
Nga/Od/From:	znj. Vjollca Vuçitërna, Drejtoreshë e DKA-së
Subjekti/Predmet/Subject:	P ë l q i m

Me kërkesën e z. Sinan Dërmala nga Rahoveci, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec I miraton kërkesën për hulumtim të temës së lartëcekur në shkollën e mesme "Xhelal Hajda-Toni" në Rahovec

Lutet drejtori I shkollës dhe mësimdhënësit që të bashkëpunojnë me personin në fjalë.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria Komunale për Arsim
Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +381 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>